

 **FEDERATA E FUTBOLLIT
E KOSOVËS**
Nr. Ref. 629/12
Data 05.07.2024
Nënshkrimi [Signature]
Prishtinë




REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 418/24 Dt. 09.07.2024

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NË MES TË

FEDERATËS SË FUTBOLLIT TË KOSOVËS

DHE

KOMUNËS SË PRIZRENIT

Palët në marrëveshje:

1. **Federata e Futbollit e Kosovës** në Prishtinë, adresa rruga 28 Nëntori, Nr. 171, me numër të regjistrimit 5100477-9 dhe numër fiskal 600062327, përfaqësuar nga z. Agim Ademi - Kryetar (i quajtur më poshtë “Federata” ose “FFK”), në njërën anë; dhe
2. Komuna e Prizrenit, me seli në rrugën “Remzi Ademaj” p.n., përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Shaqir Totaj- (referuar më poshtë “Komuna e Prizrenit” ose “Komuna”),

Hyrje:

FFK është organizatë sportive e pavarur joqeveritare dhe jo fitimprurëse. FFK organizon, mbikëqyrë dhe udhëheq garat e futbollit të të gjitha kategorive dhe është pronare e të gjitha të drejtave, për të gjitha ndeshjet e futbollit në Republikën e Kosovës.

Komuna e Prizrenit është pronare e parcelës me sipërfaqe 78.874 m², me numër të njësisë kadastrale P-71813034-00006-0, Kabash i Hasit, Komuna e Prizrenit, ku Komuna e Prizrenit ka shpreh gatishmërinë që të bashkëpunoj me FFK-në për realizimin dhe kryerjen e punëve për stadium në Kabash të Hasit, Komunë e Prizrenit.

Në bazë të diskutimeve të mëparshme, në shprehje të vullnetit të tyre të lirë, e në pajtim me kompetencat e tyre statutare, Ligjin e Sportit dhe Ligjin tjera të aplikueshme, palët si më poshtë dakordohen që të lidhin këtë kontratë konform kushteve të caktuara si më poshtë.

Neni 1

Qëllimi i Bashkëpunimit

- 1.1 Palët janë të gatshme që të angazhohen dhe bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e këtij Memorandum Bashkëpunimi.
- 1.2 Federata si dhe Komuna e Prizrenit ndajnë të njëjtat vlera rreth idesë për bashkëpunimin dhe për realizimin e investimeve në fushën e stadiumit në fshatin Kabash- Has në Komunën e Prizrenit.
- 1.3 Palët janë dakorduar që ky Memorandum Bashkëpunimi, të filloj më së largu një javë nga nënshkrimi i memorandumit dhe të zgjas derisa të realizohet projekti për çka është edhe qëllimi i këtij memorandum. Ndërkaq, plani i investimit dhe ndërtimi i stadiumit, do të përcaktohet me marrëveshje të veçantë, në përputhje me këtë Memorandum.

Neni 2

Objekt i bashkëpunimit

2.1. Palët pajtohen që objekt i këtij bashkëpunimi do të jetë realizimi i përbashkët i tyre në investimin e kryerjen e punëve në fushën e fshatit Kabash i Hasit në Komunën e Prizrenit, së bashku me objektet tjera përcjellëse. Detajet e investimit për Komunën dhe FFK-në janë të përcaktuar në paramasën dhe parallogarinë e cila është pjesë përbërëse e këtij memorandum si Annex 1 për investimet nga Federata dhe si Annex 2 për investimet nga Komuna.

2.2 Detajet në lidhje me investimin e paraparë janë pjesë e projektit investiv që është pjesë përbërëse e këtij Memorandum.

Neni 3

Komunikimi dhe takimet informuese

3.1 Palët janë pajtuar që të caktojnë nga një person kontaktues e që përgjegjësi e tyre do të jetë realizimi i plotë i këtij Memorandum, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe efikas.

3.2 Për Federatën, si person kontaktues për komunikim është caktuar z. Indrit Canolli 048 810 888 – Zyrtar i Projekteve i Federatës ose ndonjë person tjetër i përcaktuar me shkrim nga Federata, ndërsa për Komunën e Prizrenit është Adem Morina 044286223, ose ndonjë person tjetër i caktuar nga Komuna.

3.3 Kur është e nevojshme, palët bashkëpunojnë në përgatitjen dhe ofrimin e takimeve informuese.

3.4 Takimet ndërmjet palëve mbahen sipas nevojës dhe organizohen prej njëres nga palët sipas kërkesës.

4.1 Me këtë Memorandum Bashkëpunimi, palët janë pajtuar që të gjitha obligimet financiare për realizimin e këtij investimi do të bëhen bashkërisht nga palët në përputhje me këtë Memorandum dhe Annex-et e bashkëlidhura.

4.2 Palët janë pajtuar që për realizimin e këtij investimi, Komuna e Prizrenit do të sigurojë tokën në të cilën do të bëhen investimi, lejet përkatëse dhe do të kryejë investimet infrastrukturore, zhveshtoret, ndërsa Federata do të rregulloj pjesën tjetër të punimeve dhe të sigurojë barin e stadiumit. Detajet e Investimit të palëve janë të përcaktuara në paramasat dhe parallogaritë që janë pjesë përbërëse si anexe të kësaj kontrate.

Neni 5

Obligimet e palëve

5.1 Federata, në bashkëpunim me Komunën e Prizrenit, është e obliguar t'i përmbushë detyrimet konform paramasës dhe parallogarisë në Anex 1 si në vijim:

A: Punët e Fushës

- a) Punimin e projektit të Fushës, menaxhimit dhe mbikëqyrja;
- b) Furnizimin dhe montimin e Barit Artificial;
- c) Furnizimin dhe montimin e Gomes;
- d) Furnizimin dhe montimin e Portave.

Në total FFK do të kryej punë në vlerën prej **–251.000,00 Euro**

Detajet e punëve që duhet të kryhen nga FFK-ja janë të përcaktuara në paramasën dhe parallogarinë që është pjesë përbërëse e kontratës si Anex 1 për Fazën e parë dhe Anex 2 për Fazën e dytë.

Federata do të kryej të gjitha pagesat për punët e lartëcekura direkt kompanisë së përzgjedhur nga ana e saj, konform paramasës dhe parallogarisë si Anex 1 që është pjesë e bashkëlidhur e këtij memorandum.

5.2 Komuna e Prizrenit është e obliguar t'i përmbushë detyrimet në konformitet me paramasën dhe parallogarinë që i është bashkëlidhur këtij memorandum si Anex 2 ndër të tjera dhe përfshin si në vijim:

- a) Punët e Përgaditore;
- b) Punët e Minimit, Gërmimit të Fushës;

Nëse është e nevojshme Komuna do të siguroj pëlqimet dhe lejet përkatëse për ndërtimin e stadiumit.

Pozicionet e lartëshënuara arrijnë vlerën prej **249.350,00 € dhe paguhen nga Komuna e Prizrenit.**

Pagesat për punët e kryera nga paragrafi 5.2 do të realizohen në dy pjesë pas aprovimit nga organi përkatës i Komunës. Zyrta e përgjegjëse për realizimin e projektit nga Komuna e Prizrenit është Adem Morina, ose ndonjë zyrtar tjetër i caktuar nga Komuna.

5.3 Procedurat e përzgjedhjes së kompanisë/vë për kryerjen e të gjitha punëve nga pika 5.1 dhe 5.2 do të udhëheqën nga FFK-ja për shkak të specifikave të projektit dhe përvojës së kësaj të fundit në realizimin e projekteve të njëjta në të gjithë Kosovën, ndërsa pagesa do të bëhet direkt te kompania e përzgjedhur nga secila palë pas aprovimit përkatës nga organi i tij mbikëqyrës.

Neni 6

Ndryshimi dhe përfundimi i Memorandumit

6.1 Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim nga ana e dy palëve. Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum.

6.2 Palët në këtë marrëveshje janë dakorduar që cilado nga palët mund ta ndërprejë këtë memorandum me njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh të dhënë palës tjetër.

Neni 7

Ligji i aplikueshëm për interpretim

7.1. Ky Memorandum do të qeveriset nga ligjet e Republikës së Kosovës.

7.2 Ky Memorandum do të interpretohet duke konsideruar termat dhe kushtet e tij në tërësi. Në çdo rast, nëse ndonjë fjalë, fjali apo nen i caktuar sjellë paqartësi, ajo duhet të shikohet në tërësinë e këtij Memorandumi.

7.3 Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve në fuqi, është Ligji kompetent për interpretimin dhe plotësimin e vullnetit të palëve në këtë Memorandum.

7.4 Gjuha shqipe do të jetë gjuha e këtij Memorandumi, dhe po ashtu gjuha e interpretimit të këtij Memorandumi.

Neni 8
Hyrja në fuqi


Ky Memorandum hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit nga të dy palët. Memorandumi i lartëcekur do të lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore dhe do të përpilohen në dy kopje origjinale.

Federata e Futbollit të Kosovës

Kryetari:

Agim Ademi

agimademi@ffk-kosova.com



Komuna e Prizrenit

Kryetari:

Shaqir Totaj



05.07.2024

Prishtinë, Kosovë